



BALFIN SHPK

Pasqyrat Financiare per vitin ushtrimor 2016

INDIVIDUALE

Përmbajtja

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....	3
PASQYRA PËRMBLEDHËSE E TË ARDHURAVE	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL.....	5
PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË.....	6
SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE	6-21

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarët e Balfin sh.p.k

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Balfin sh.p.k ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2016, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2016, dhe rezultatin e saj financiar dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit ("SKK"), siç përshkruhet në shënimin 2.

Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA-të"). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjëstë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me *Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël* të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël ("Kodi i BSNEPK") së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Baza e kontabilitetit dhe qëllimi i përgatitjes

Tërheqim vëmendjen në Shënimin 2 të pasqyrave financiare, që tregon Bazat e përgatitjes të pasqyrave financiare dhe faktin që këto pasqyra financiare janë përgatitur për qëllim të përmbushjes së kërkesave statutore për auditimin e pasqyrave financiare vjetore. Pasqyrat financiare mund të mos jenë të përshtatshme për tu përdorur për qëllim të përgjithshëm.

Përgjegjësitë e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, dhe për ato kontrole të brendshme që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër. Drejtimi është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, priten që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- ▶ Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- ▶ Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, të cilat mund të hedhin dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- ▶ Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrijnë paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin e Balfin sh.p.k, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar
Dega Shqipëri

Ernst & Young Certified Auditors
31 mars 2017
Tiranë, Shqipëri



Mario Vangjel
Ekspert Kontabël i Regjistruar

BALFIN SH.P.K*(Gjithë vlerat janë shprehur në Lek)***PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR**

AKTIVET	Shenime	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Aktivët Afatshkurtra			
Mjete monetare	4	3,100,742,849	136,967,533
Totali		3,100,742,849	136,967,533
Aktive të tjera financiare afatshkurtra			
Llogari / Kërkesa të arkëtueshme	5	68,537,629	74,236,544
Huadhenie afatshkurter brenda grupit	6	667,096,639	-
Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme	7	325,117,876	43,999,177
Totali		1,060,752,144	118,235,721
Inventari			
Lëndët e para/Inventar i imet		-	-
Shpenzime të shtyra dhe të ardhura të llogaritura	8	2,840,685	1,448,977
Totali		2,840,685	1,448,977
AKTIVET TOTALE AFATSHKURTRA		4,164,335,678	256,652,231
Aktivët Afatgjatë			
Investimet financiare afatgjatë			
Aksione dhe pjesëmarrje të tjera në njësi të kontrolluara (pasqyrat financiare të pakonsoliduara)	9	3,908,275,032	2,808,509,397
Aksione dhe investime të tjera në pjesëmarrje	10	257,772,426	779,034,885
Llogari / Kërkesa të arkëtueshme afatgjatë	11	819,226,048	1,872,060,005
Tituj të huadhenies në njësitë brenda grupit	12	421,452,561	427,908,934
Tituj të tjere të huadhenies	12	559,145,776	567,554,645
Totali		5,965,871,843	6,455,067,866
Aktive afatgjatë materiale	13		
Makineri dhe pajisje, neto		4,945,876	9,359,411
Aktive të tjera afatgjatë materiale, neto		25,124,500	16,492,790
Totali		30,070,376	25,852,201
Aktive biologjike afatgjatë			
Aktivët afatgjatë jomateriale			
Aktive të tjera afatgjatë jomateriale		724,788	869,745
Totali		724,788	869,745
TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA		5,996,667,007	6,481,789,813
TOTALI AKTIVEVE		10,161,002,685	6,738,442,043
PASIVET DHE KAPITALI			
Huat dhe obligacionet afatshkurtra	14	226,789,164	246,141,363
Totali		226,789,164	246,141,363
Te pagueshme ndaj furnitorëve	15	52,393,122	49,138,711
Detyrimet tatimore	16	6,059,338	5,725,699
Dividend për tu paguar		-	-
Totali		285,241,623	301,005,773
Grandet dhe të ardhurat e shtyra	16	-	-
TOTALI I PASIVEVE AFATSHKURTRA		285,241,623	301,005,773
Huamarrje të tjera afatgjatë	17	2,751,881,377	2,151,624,146
TOTALI I PASIVEVE AFATGJATA		2,751,881,377	2,151,624,146
TOTALI I PASIVEVE		3,037,123,001	2,459,617,636
Kapitali aksionar		3,216,205,000	3,216,205,000
Rezerva ligjore		199,859	199,859
Fitimet e pashpërndara		1,069,407,265	392,013,262
Fitimi e vitit financiar		2,838,067,560	677,394,003
TOTALI I KAPITALIT		7,123,879,684	4,285,812,124
TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT		10,161,002,685	6,738,442,043

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga 1 deri në 25 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.


BALFIN SH.P.K*(Gjithë vlerat janë shprehur në Lek)***PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHEPËRFSHIRESE**

	Shenime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga dividendet	18	3,241,124,124	688,729,675
Të ardhura nga shërbimet	19	261,455,410	177,183,008
Shpenzime nga veprimtari të shfrytëzimit	20	(489,440,145)	(95,724,260)
Shpenzime të personelit	21	(106,335,682)	(75,615,172)
Pagat		(96,880,061)	(68,372,471)
Shpenzimet e sigurimeve shoqërore		(9,455,621)	(7,242,701)
Rënia në vlerë (zhvlerësimi) dhe amortizimi		(7,424,267)	(6,921,407)
Fitimi nga veprimtari të shfrytëzimit		2,899,379,440	687,651,844
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare		(61,311,880)	(9,034,391)
Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi	22	(2,703,994)	(585,985)
Fitimet/(humbjet) nga kursi i këmbimit		(58,607,886)	(8,448,406)
Fitimi para tatimit		2,838,067,560	678,617,453
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin 15 %	23	-	(1,223,451)
Fitimi (humbja) neto e vitit financiar		2,838,067,560	677,394,003

Emri/Firma

 Administratori



Emri/Firma

 Menaxhere e Financës

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga 1 deri në 25 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

BALFIN SH.P.K*(Gjithë vlerat janë shprehur në Lek)***PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL**

	Kapitali aksionar	Aksione të thesarit	Rezerva ligjore	Fitim i pashpërndarë	Totali i kapitaleve të veta
Pozicioni më 31 dhjetor 2014	3,216,205,000	-	199,859	392,013,262	3,608,418,120
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-	-	677,394,003	677,394,003
Dividendët e paguar	-	-	-	-	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2015	3,216,205,000	-	199,859	1,069,407,265	4,285,812,124
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-	-	2,838,067,560	2,838,067,560
Dividendët e paguar	-	-	-	-	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2016	3,216,205,000	-	199,859	3,907,474,825	7,123,879,684

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga 1 deri në 25 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE

Shenime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015
Fluksi parave nga veprimtaritë e shfrytëzimit		
Fitimi para tatimit	2,838,295,099	678,617,453
Rregullimet për :		
Te ardhura nga dividendet	(3,241,124,124)	(688,729,675)
Amortizimin	12 7,424,267	6,921,407
Humbjet (fitimet) nga këmbimet valutore	27,503,463	(6,064,632)
Fitime nga shitja e aktiveve afatgjate	12 (238,486)	309,456
Rritje / rënie në kërkesa te arketueshme nga aktiviteti, dhe kërkesave te tjera	108,925,826	784,406,671
Rritje / rënie ne tepicën inventarit	-	8,755
Rritje / rënie në tepicën detyrimeve, për t`u paguar	87,492,618	(163,941,710)
Tatim fitimi i paguar	23 -	(11,519,451)
	(171,948,876)	611,527,725
Paraja neto nga aktivitetet e shfrytëzimit		
Fluksi i parave nga veprimtarite e investuese		
Rritje aksione dhe pjesëmarrje te tjera ne njeri te kontrolluara	(1,099,765,635)	(431,902,040)
Pakesim aksione dhe investime te tjera	521,262,459	(32,521,779)
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	12 (14,081,399)	(9,040,576)
Të ardhura nga shitja e paisjeve	2,345,427	2,149,040
Dividendët e arkëtuar	3,241,124,124	688,729,675
Hua te dhena	11 (14,865,242)	(995,463,579)
	2,636,019,734	(778,049,258)
Paraja neto, e perdorur ne aktivitetet investuese		
Fluksi i parave nga veprimtarite financuese		
Te ardhura nga emetimi i kapitalit aksionar		
Huamarrje te marra, neto	497,000,463	270,578,663
Interesi i paguar	13,346,437	5,498,284
Interesi i arkëtuar	(10,642,442)	(4,912,298)
	499,704,458	271,164,649
Para neto e perdorur ne aktivitetet financiare		
Rritja/renia neto e mjeteve monetare nga aktiviteti	2,963,775,316	104,643,115
Mjete monetare ne fillim te vitit	5 136,967,533	32,324,417
Mjete monetare ne fund te vitit	3,100,742,849	136,967,533

Pasqyra e fluksit te mjeteve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga 1 deri ne 25 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. INFORMACIONE TE PERGJITESHME

Balfin sh.p.k. është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me datë 25 Tetor 2007 dhe është regjistruar në Qendren Kombëtare të Regjistrimit në regjistrin e shoqërive tregtare në të njëjtën ditë, me kapital të nënshkruar prej 100,000 leke. Me datë 08.04.2008 në Qendren Kombëtare të Regjistrimit, shoqëria ndryshon emrin e saj nga Samir Mane Consulting Group në Balfin Shpk. Me datë 24.10.2008 në Qendren Kombëtare të Regjistrimit rritet kapitali i shoqërisë me 12,300,000 leke, në datën 05.07.2009 në Qendren Kombëtare të regjistrimit rritet kapitali i shoqërisë me 2,330,580,000 leke. Në datën 19.03.2012 në Qendren Kombëtare të Regjistrimit rritet kapitali i shoqërisë në natyrë për vlerën 873,225,000 leke Kapitali i shoqërisë në 31.12.2014 është 3,216,205,000 leke. Administrator dhe aksioner i vetëm është Z.Samir Mane i cili zoteron 100% të aksioneve të shoqërisë me vlerë nominale për një aksion 32,162,050 leke.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatëse të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, nga statuti i saj dhe legjislacioni shqiptar në fuqi për tatimet dhe taksat.

Objekti: Aktiviteti i Shoqërisë është investimi dhe konsulenca.

Certifikimi tatimor: NIPT K72223031K

Forma juridike e shoqërisë: Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar

Adresa e selisë: ABA Busines Center, Kati 11, Tirane

Shoqëria kryen aktivitetin e saj në ambiente që janë të mara me qira.

2. BAZA E PREGATITJES SE PASQYRAVE FINANCIARE

2.1 Bazat e përgatitjes

Kompania ka përgatitur keto pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (“SKK”) për pasqyrat financiare të vecanta me qëllim plotësimin e kërkesave për raportim të pasqyrave financiare ligjore.

Meqënëse SKK kërkon përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, pasqyrat financiare të vecanta mund të mos jenë të mjaftueshme për t’u përdorur si pasqyra financiare me qëllim të përgjithshëm për të plotësuar kërkesat e gjithë përdoruesve të pasqyrave financiare. Pasqyrat e konsoliduara të Shoqërisë do të lëshohen pas datës së aprovimit të këtyre pasqyrave.

Shoqëria i mban të dhenat e kontabilitetit dhe publikon pasqyrat e saj financiare të vitit 2016 në bazë të Standardeve Kombëtare të Raportimit Financiar (“SKK”), të shpallura me Urdhërin e Ministrit të Financave Nr. 4292 datë 15.06.2006 dhe në përputhje me Ligjin mbi kontabilitetin no: 9228 datë 29 Prill 2004 “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.

Aktivitetet financiare dhe detyrimet financiare janë të kompensuara dhe shumat neto raportohen në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ka të drejtë ligjore për t’i kompensuar shumat e njohura dhe ka një përpjekje për t’i vendosur në bazë neto, ose për realizimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet nuk janë të kompensuara në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse pasi nuk kërkohet ose lejohet nga ndonjë standard i kontabilitetit ose interpretim, dhe ndonjë politikë kontabël e Shoqërisë.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2. BAZA E PREGATITJES SE PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)**2.4 Vlerësime dhe gjykime**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që Drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë dhe në njohjen dhe matjen e shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacioni mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishëm në shumën e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet shpjeguese përkatëse të këtyre pasqyrave financiare.

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL**3.1 Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit këmbehen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit të asaj date. Fitimi ose humbja nga kurset e këmbimit për zërat monetarë është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhë funksionale në fillim të vitit dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të këmbyerës me kursin e këmbimit në fund të vitit.

Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare të nominuara në monedhë të huaj të cilat maten me vlerë të drejtë këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilën është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jo-monetarë në monedhë të huaj të cilat maten me kosto historike këmbehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Kurset e këmbimit zyrtare bankare të zbatuara sipas Bankës së Shqipërisë (Lek kundrejt njësisë së monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 ishin si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
USD	128.17	125.79
EUR	135.23	137.28

3.2 Instrumentat Financiare

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme, mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë, huamarrje, dhe llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur Shoqëria transferon aktivitetin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivitetin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.2 Instrumentat Financiare (vazhdim)

Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë

Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, mjetet monetare dhe të tjerë ekuivalentë përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Huamarrje

Huamarrjet njihen fillimisht me kosto dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve.

Të tjerë

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Vlera e drejtë

Vlera e drejtë e përlllogaritit për mjetet monetare dhe të tjerë ekuivalentë, llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme, llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme, huamarrjeve, përafron me vlerat e tyre kontabël.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital.

3.3 Aktivët Afatgjatë investimi

Aktive afatgjatë investimi, të cilat janë prona të mbajtura për të fituar të ardhura nga qerata dhe / ose për rivlerësimin e kapitalit (duke përfshirë prona në ndërtim për qëllime të tilla), maten fillimisht me kosto, duke përfshirë koston e transaksionit. Ato njihen fillimisht në pasqyrën e pozicionit financiar në momentin që rreziqet dhe përfitimet nga pronësia transferohen te shoqëria pavarësisht nga fakti nëse titulli është transferuar apo jo. Ato maten fillimisht me kosto. Pas momentit të njohjes, në vijim aktivët afatgjatë investimi maten me modelin e koston. Aktivët afatgjatë investimi, të cilat janë në proces ndërtimi të lidhura me projekte të reja me të cilat po merrët shoqëria, për ndërtimin e magazinave që do të jepen me qera ku përfshirja e shoqërisë në menaxhimin do të jetë minimale. Si e tillë, shoqëria po llogarit kostot direkte të ndodhura gjatë procesit të ndërtimit dhe sjelljes së aktivitetit në kushtet për tu dhënë me qera.

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.4 Aktivet Afatgjata Materiale

Njohja dhe matja

Te gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostot përfshijnë shpenzimet që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe kosto të tjera që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë për sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin që i është caktuar, kostot e çmontimit dhe lëvizjes së aktiveve dhe kthimin e vendodhjes së tyre në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot e kapitalizuara të huave. Kostot gjithashtu mund të përfshijnë zëra të transferuar nga të ardhurat të tjera përmbledhëse për fitime apo humbje të kualifikimit të flukseve të parasë të mbuluara nga blerjet në monëdhë të huaj të aktiveve afatgjata materiale. Blerja e programeve kompjuterike të cilat janë pjesë përbërëse e funksionimit të paisjeve përkatëse kapitalizohet si pjesë e asaj paisjeje. Në momentin që një nga aktivet afatgjata materiale përbëhet nga pjesë me jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato regjistrohen si pjesë të ndara nga njëra tjetra. Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale percaktohen duke krahasuar arkëtimet nga shitja me vlerën kontabël neto të aktivitetit afatgjatë material dhe njihen neto në të ardhura ose humbje të tjera.

Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur, për të gjitha aktivet, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Përmirësimet e aktiveve të marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Toka nuk amortizohet.

Jetëgjatësia e vlerësuar për periudhën aktuale dhe metodat respektive të amortizimit janë si më poshtë:

a) Makineri e Pajisje	20%
b) Mjete transporti	20%
c) Pajisje informatike	25%
d) Instalime	20%
e) Te tjera	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.5 Aktive afatgjata jomateriale

Njohja dhe matja

Aktivitet jomateriale të blera nga shoqëria maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe rënie në vlerë të akumuluar.

Kostot në vijim

Kostot në vijim kapitalizohen vetëm kur ato rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike nga aktivi specifik me të cilat lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera, duke përfshirë shpenzimet e gjenerimit të emrit të mirë dhe markës, njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse (në humbje ose fitime) në momentin e ndodhjes.

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.5 Aktive afatgjata jomateriale (vazhdim)

Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi koston e aktiveve, ose cdo vlerë tjetër të konsideruar si kosto, minus vlerën e mbetur. Amortizimi njihet në të ardhura ose shpenzime duke përdorur metodën e vlerës së mbetur.

Zhvleresimi

Aktivitet financiar

Një aktiv financiar që nuk mbahet me vlerën e drejtë, vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna objektive që ka pësuar rënie në vlerë. Një aktiv financiar bie në vlerë nëse ka të dhëna objektive të një ngjarje që ka çuar në rënien e vlerës së tij pas momentit fillestar të njohjes së aktivitetit, dhe kjo ngjarje ka efekt negativ në vlerësimin e flukseve të ardhshme nga aktiviteti të cilat mund të maten me besueshmëri.

Humbja nga rënia në vlerë e aktivitetit të vlerësuar me koston e amortizuar llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme që priten të gjenerohen nga ky aktiv financiar të aktualizuara me normën fillestare efektive të interesit. Humbjet njihen në

pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse (në humbje ose fitim) në një llogari zbritje kundër të arkëtueshmet. Interesi nga aktivitetet e zhvlerësuar në këtë mënyrë vazhdon të njihet nëpërmjet amortizimit të skontos. Kur një ngjarje pasuese shkakton zvogëlimin e rënies në vlerë, shumat përkatëse rimerret nëpërmjet pasqyrës përmbledhëse të të ardhurave, fitimit ose humbjeve.

Aktivitet jo financiar

Vlera kontabël e aktiveve jo financiare të shoqërisë rishikohet në datën e raportimit për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dhënë për rënie në vlerë. Nëse ekziston ndonjë evidence e tillë atëherë matet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Vlera e rikuperueshme është vlera më e madhe midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Gjatë vlerësimit të vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të vlerësuar skantohen në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqeve specifike të aktiveve që nuk janë marrë parasysh në vlerësimin e flukseve të ardhshme. Humbje nga rënia e vlerës njihet nëse vlera kontabël e aktivitetit ose e njësisë së tij të gjenerimit të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

3.6 Provigjonet

Provigjoni njihet kur, si pasojë e ngjarjeve të kaluara, shoqëria ka detyrime aktuale ligjore apo konstruktive të cilat mund të vlerësohen me vërtetësi, dhe ka mundësi që të ketë nxjerrje të flukseve të ardhshme të parasë për të shlyer këtë detyrim. Provigjonet përcaktohen nga aktualizimi i flukseve të pritshme me një normë para tatimi që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të parasë dhe rrezikut specifik të detyrimeve.

3.7 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë flukset bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës të cilat gjenerohen përgjatë ecurisë normale të aktiviteteve të biznesit.

Të ardhurat janë hyrje bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës, të cilat vijnë nga veprimtaria e zakonshme e një njësie ekonomike kur këto hyrje sjellin rritje në kapitalin neto, përveç rritjeve që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital. Të ardhurat përfshijnë vetëm vlerën e drejtë të përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga shitja e mallrave dhe shërbimeve gjatë aktivitetit të zakonshëm të kompanisë. Të ardhurat përfshijnë

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.7 Njohja e të ardhurave (vazhdim)

shumat neto pa përfshire shumat e mbledhura për llogari të palëve të treta si taksat e shitjes, taksat e mallrave, produkteve dhe shërbimeve, si dhe tatimi i vlerës së shtuar, të cilat nuk janë përfitime ekonomike që hyjnë në njësinë ekonomike dhe nuk sjellin rritje të kapitalit neto. Në lidhje me shitjen e mallrave, të ardhurat janë njohur kur ndryshimi i pronësise se bashku me riskun që vjen nga ky ndryshim, janë transferuar tek blerësi.

3.8 Të ardhurat nga qeratë

Të ardhurat nga qeraja janë të ardhura të përfituara nga kontratat e qerasë, përveç të ardhurave të kushtëzuara të qerasë të cilat njihen kur përfitohen. Kostot fillestare direkte që ndodhin gjatë negociimit të një kontrate qeraje njihen si shpenzime në termat e qerasë me të njëjtat baza sit ë ardhurat nga qeraja.

Përpyjekjet për të nënshkruar një kontratë qeraje janë shpërndarë në mënyrë të barabartë përgjatë aftatit të kontratës së qerasë edhe nëse këto pagesa nuk bëhen në këto baza. Afati i qerasë është një periudhë e pa anulueshme qeraje së bashku me afate të tjera të mëtejshme për të cilat qeramarrësi ka opsionin për të vazhduar qeranë, kur, në fillim të qerasë drejtimi ka një siguri të arsyeshme që qeramarrësi do ta ushtrojë këtë opsion.

Shumat e marra nga qeramarrësi për përfundimin e qerasë ose kompesimin e përfundimit të saj njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse kur lind e drejta për ti marrë ato.

3.9 Pagesat për qeranë financiare

Qeratë klasifikohen si qera financiare kur kushtet e qerasë transferojnë në mënyrë domethënëse të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë tek qeramarrësi. Të gjitha qeratë e tjera klasifikohen si qera operative. Pagesat e bëra për qeranë operative janë paraqitur në pasqyrën e të ardhurave në bazë lineare përgjatë kohëzgjatjes së kontratës

Depozitimet e qeramarrësit

Detyrimet e depozitimeve të qeramarrësit fillimisht njihen me vlerë të drejtë dhe maten më kosto të amortizueshme kur është materiale. Diferencat ndërmjet vlerës fillestare të drejtë dhe shumës nominale përfshihet si një komponent i të ardhurave nga kontrata e qerasë dhe njihen në bazë lineare përgjatë kohëzgjatjes së kontratës.

3.10 Të ardhurat financiare dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përbëhen nga të ardhurat nga interesi për fondet e investuara në depozita bankare dhe nga të ardhurat nga kursi i këmbimi.

Kostot financiare përbëhen nga shpenzimet e interesit të huave, shpenzime nga kurset e këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare në fitim dhe humbje nga rënia në vlerë e aktiveve financiare.

Humbjet apo fitimet nga kursi i këmbimit janë paraqitur në vlerë neto.

3.11 Kostot e huamarrjes

Kostot e huave të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e aktiveve, të cilat duan një kohë të gjatë për t'u sjellë në formë përfundimtare, në mënyrë që të përdoren apo shiten, i shtohen koston së këtyre aktiveve, deri në momentin kur këto aktive janë gati për qëllimin e tyre për përdorim ose për shitje.

Të ardhurat nga investimet e përkohshme, për sa i përket disa huave të veçanta, të cilave ende nuk ju është paguar interesi, kjo shumë ju zbritet kostove të huamarrjes dhe nuk i kapitalizohet koston së aktivitetit. Të gjitha kostot e tjera njihen si të ardhura ose shpenzime në periudhën kur ato kanë ndodhur.

3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.12 Taksat

Bazuar në SKK 11 "Tatimi mbi fitimin", duke filluar nga viti 2015, ky standard behet i detyrueshem njohja e detyrimeve ose aktiveve tatimore te shtyra. Shoqëria nuk ka aktive apo detyrime tatimore te shtyra në pasqyrat financiare për periudhën që mbyllet më 31 dhjetor 2016.

Tatimi mbi fitimin nënkupton tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përveç rasteve kur lidhen me zera të njohur direkt në kapital, në të cilat regjistrohen direkt në kapital.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm, i pagueshëm mbi fitimin e tatueshem për vitin, duke përdorur normat e tatimeve në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme.

BALFIN SHPK*(Gjithë vlerat janë shprehur në Lek)***4 MJETE MONETARE DHE TE TJERE EKVIVALENTE**

Mjetet monetare dhe të tjerë ekuivalentë më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 përbëhen si më poshtë:

Mjete Monetare	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
I. Para në dore	22,326	24,698
Ne monedhe vendase	3,006	5,717
Ne monedhe të huaj	19,320	18,981
II. Llogari në banke	2,424,070,523	132,365,695
Ne monedhe vendase	78,952,497	13,024,575
Ne monedhe të huaj	2,345,118,026	119,341,120
III. Depozite afatshkurter	676,650,000	4,577,140
Total mjete monetare (I+II+III)	3,100,742,849	136,967,533

5 KERKESA TE ARKETUESHME

Ne këte zë janë përfshirë "Kërkesa të arketueshme" nga klientet dhe shoqëri të Grupit.

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Sherbime konsulence drejt shoqërive të Grupit	56,765,148	67,656,339
Sherbime konsulence drejt klienteve të tjera	11,772,481	6,580,205
Totali	68,537,629	74,236,544

6 HUADHENIE AFATSHKURTER BRENDA GRUPIT

Tituj të huadhenies afatshkurter brenda përbehen si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Huadhenie drejt shoqërive të Grupit	667,096,639	-
Totali	667,096,639	-

7 KERKESA TE TJERA TE ARKETUESHME

Kërkesa të tjera të arketueshme më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 përbehen si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Kërkesa të tjera nga kompani të kontrolluara	227,221,289	-
Hua ndaj paleve të Treta	48,875,484	1,568,408
Huadhenie pa interes brenda grupit	26,710,049	-
Kërkesa të tjera nga kompani jo të kontrolluara	11,845,201	25,900,574
Parapagime të dhena	5,000,381	7,097,729
Tatim Fitim i Parapaguar	3,080,296	3,308,283
Kliente për fatura të pambërritura	1,814,455	-
Paradhenie Punonjesve	570,720	655,047
Tatime të shtyra	-	5,469,136
Totali	325,117,875	43,999,177

BALFIN SHPK*(Gjthe vlerat jane shprehur ne Lek)***8 SHPENZIME TE SHTYRA DHE TE ARDHURA TE PERLLOGARITURA**

Shpenzime te shtyra me 31 dhjetor 2016 dhe 2015 perbehen si me poshte:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Shpenzime te periudhave te ardhshme	946,113	1,448,977
Interes i arketueshem nga huate e dhena brenda grupit	1,894,572	-
Totali	2,840,685	1,448,977

Shpenzimet e periudhave te ardhshme perfshijne shpenzime te cilat i takojne me shume se nje periudhe ushtrimore, dhe amortizohen ne nje vit kalendarik te tilla si: sigurime vjetore per automjtet e shoqerise, abonime etj keto shpenzime nuk i perkasin te gjithë vitit 2016 dhe si te tilla jane klasifikuar si shpenzime te shtyra per tu amortizuar ne vitin 2016. Te ardhurat e perlllogaritura jane te ardhura qe priten te arketohen nga interesat e depozitave dhe fondeve te dhena hua.

9 AKSIONE DHE PJESEMARRJE TE TJERA NE NJESITE E KONTROLLUARA

Ky ze perfshin investimet e shoqerise ne blerjen e aksioneve te paleve te lidhura. Ne tabelen e meposhteme jepet pjesemarrja ne vlere dhe perqindje deri me date 31.12.2016.

Investime ne njesi te kontrolluara	31 dhjetor 2016	%	31 dhjetor 2015	%
Tirana Logistic Park	1,476,168,030	64,41%	1,476,168,030	64,41%
Mane TCI	689,750,000	100%	689,750,000	100%
Almark	600,502,975	100%	79,786,500	100%
Green Coast	434,734,680	100%	70,045,680	100%
Agrocon	203,310,000	100%		
ALCRED	114,722,879	100%	114,722,879	100%
AES	101,302,500	100%	100	100%
Neptun	90,000,000	90%	90,000,000	90%
MZF	86,600,000	100%	86,600,000	100%
BFI Invest	67,355,100	100%	100	100%
Neptun Maqedoni	19,452,131	60%	19,452,131	60%
Stella Mare	13,694,000	50%	-	
Acr Srl	5,143,549	100%	139,720,000	100%
Neptun Ks	4,199,100	60%	4,199,100	60%
SACCTA	909,992	65%	909,992	65%
ACREM	100,000	100%	100,000	100%
Albchrome Holding	100,000	100%	100,000	100%
Electroservice	90,000	90%	90,000	90%
Kid Zone KS	76,951	55%	76,951	55%
Kid Zone doo	63,055	90%	-	
Kid Zone	90	90%	90	90%
RFZ Building	-	100%	20,716,375	100%
BookStore	-	100%	16,071,470	100%
Total	3,908,275,032		2,808,509,397	

10 AKSIONE DHE INVESTIME TE TJERA NE PJESEMARRJE

Ne kete ze perfshihen investimet ne shoqerite e pakontrolluara (aksione dhe pjesmarrje te tjera ne njesi te pa kontrolluara). Ne daten 31.12.2016 situata paraqitet si me poshte e detajuar.

Investime ne njesi jo te kontrolluara	31 dhjetor 2016	%	31 dhjetor 2015	%
Balfin Finance B.V	135,759,854	50%	687,017,560	38.50%
FINAL	55,250,113	40.43%	63,373,126	48.43%
Investment Joti	36,750,000	49%		
Milsped	28,040,000	50.00%	28,040,000	50.00%
Balfin BV	1,369,400	100%		
TBU	428,571	30.00%	428,571	30.00%
Macrem	174,488	25.00%	174,488	25.00%
Te tjera	-	-	1,140	20.00%
Total	257,772,426		779,034,885	

11 LLOGARI/KERKESA TE ARKETUESHME AFATGJATA

Llogarite e Arketueshme Afatgjata jane kryesisht nga kompani te cilat jane ne zoterim nga Balfin sh.p.k. Llogari/Kërkesa të Arkëtueshme Afatgjata përbëhet si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Nga shoqeri te kontrolluara	770,394,337	1,804,234,851
Nga shoqeri jo te kontrolluara	481,125	488,419
Te tjera	48,350,586	67,336,735
Total	819,226,048	1,872,060,005

12 TITUJ TE HUADHENIES

Tituj te huadhenies perbehen si me poshte:

Tituj te huadhenies	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Tituj te huadhenies afatgjate brenda grupit	421,452,561	427,908,934
Tituj te tjere te huadhenies	559,145,776	567,554,645
Total	980,598,337	995,463,579

Huadhenie brenda grupit eshte vlera e mbetur e huadhenies per nje nga kompanite qe zoterohet komplet nga grupi Mane TCI. Ndersa huadhenie te tjera perfshijne huadhenie ne favor te nje prej kompanive ku Shoqeria ka pjesemarrje ne referim te kontrates se huase. Gjate 2017, ne baze te nje marreveshje midis paleve do te cedoje te drejten qe rrjedh nga kjo kontrate tek shoqeria Mane TCI.

Duke u bazuar ne ecurine e zhvillimeve me te fundit ne kete shoqeri dhe ne besueshmerine e informacioneve qe zoterojme, kjo vlere do te rikuperohet plotesisht.

BALFIN SH.P.K*(Gjithë vlerat janë shprehur në Lek)***13 AKTIVE AFATGJATA MATERIALE**

Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale me 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 perbehet si me poshte:

Aktive Afatgjata Materiale Kosto historike:	Software	Instalime Teknike dhe Pajisje	Mjete Transporti	Pajisje zyre dhe informatike	Mobileri e Pajisje	Total
Gjendja ne 1 Janar 2015	1,159,658	4,541,384	9,779,870	32,490,055	14,107,598	62,078,565
Shtesa		7,101,815	-	1,891,840	61,083	9,054,738
Pakesime	-	(4,461,734)	(1,281,750)	-	-	(5,743,484)
Gjendja ne 31 Dhjetor 2015	1,159,658	7,181,465	8,498,120	34,381,895	14,168,681	65,389,819
Shtesa		10,074,136	10,074,136	3,296,170	711,093	14,081,399
Pakesime		(5,531,899)	(5,531,899)			(5,531,899)
Gjendja ne 31 Dhjetor 2016	1,159,658	7,181,465	13,040,357	37,678,065	14,879,774	73,939,319
Amortizimi i akumuluar:						
Gjendja ne 1 Janar 2015	(144,957)	(2,924,259)	(5,472,437)	(16,450,217)	(10,658,497)	(35,650,367)
Ndryshimi i vitit	(144,957)	1,902,659	173,862	(4,041,286)	(907,786)	(3,017,508)
Gjendja ne 31 Dhjetor 2015	(289,913)	(1,021,600)	(5,298,575)	(20,491,503)	(11,566,283)	(38,667,873)
Pakesime			2,947,987			2,947,987
Ndryshimi i vitit	(144,956)	(1,213,989)	(1,728,040)	(3,532,113)	(805,169)	(7,424,267)
Gjendja ne 31 Dhjetor 2016	(434,870)	(2,235,589)	(4,078,628)	(24,023,616)	(12,371,452)	(46,092,142)
Vlera e mbetur me:						
31 Dhjetor 2015	869,745	6,159,865	3,199,545	13,890,392	2,602,398	26,721,946
31 Dhjetor 2016	724,788	4,945,876	8,961,729	13,654,449	2,508,322	30,795,164

Drejtimi mendon se përgjithësisht për këtë vit ushtrimor kontabël, nuk ka shenja të rënies në vlerë të AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvlerësime.

BALFIN SH.P.K*(Gjithë vlerat janë shprehur në Lek)***14 HUAMARRJET AFATSHKURTRA**

Huamarrjet afatshkurtra perbehen nga pjesa afatshkurter e huamarrjes ne sistemin bankar te nivelit te dyte dhe detyrime te tjera afatshkurtra qe pritet te mbyllen brenda vitit 2016.

Hua të tjera	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Letra me Vlere	140,000,000	-
Hua afatshkurter ne sistemin bankar	48,436,986	83,477,222
Te tjera	36,750,000	15,423,888
Landeslease	1,602,178	-
Hua nga shoqeri te kontrolluara	-	147,240,253
Total	226,789,162	246,141,363

15 DETYRIME AFATSHKURTRA

Detyrime afatshkurtra perfaqeson detyrimet tregetare te kompanise per furnitoret e saj.

Te pagueshme ndaj furnitorëve	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Te pagueshme ndaj furnitorëve	52,393,122	49,138,711
Total	52,393,122	49,138,711

16 DETYRIME AFATSHKURTRA PER PUNONJESIT DHE TATIMET

Detyrimet tatimore & punonjesve	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
TVSH	1,644,873	2,826,650
Sigurime Shoqerore dhe te ngjashme	1,476,944	1,144,173
Shteti – Tatim mbi paga	1,260,521	900,218
Paga te pagueshme	854,654	854,658
Tatim ne Burim	822,346	-
Total	6,059,338	5,725,699

17 HUAMARRJE DHE DETYRIME AFATGJATA

Ne kete llogari jane paraqitur detyrimet e shoqerise per financimet e marra nga ortaku i tij i vetem si edhe nga shoqerite e grupit, per investimet e kryera. Kontributi i kryer nga ortaku do te konsiderohet te kaloje ne rritjen e kapitalit te shoqerise ne nje moment te mevonshem. Persa i perket kontributeve te marra nga shoqerite e tjera te grupit keto fonde te ti kthehen ne vitet ne vijim. Gjithashtu ketu persfshihet dhe pjesa afatgjate e detyrimeve afatgjate per huate nga sistemi bankar.

Huamarrje dhe detyrime afatgjata	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Parapagim dividenti	913,885,460	725,700,480
Hua dhe detyrime te tjera	745,660,795	-
Huamarrje nga shoqeri te kontrolluara	637,547,495	334,584,198
Kontribut nga ortaku	426,532,801	766,388,095
Hua Afatgjate nga sistemi bankar	28,254,826	187,671,373
AAEF	-	137,280,000
Total	2,751,881,379	2,151,624,146

BALFIN SHPK*(Gjthe vlerat jane shprehur ne Lek)***18 TE ARDHURA TE TJERA NGA VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT**

Ne kete ze jane perfshire te ardhurat nga dividendet. Gjate vitit 2016 shoqeria ka njohur si te ardhura nga dividenti i shperndare nga shoqerite e kontrrolluara.

Te ardhura nga Dividentet	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Te ardhura nga Dividentet nga shoqeri te kontrolluara	1,513,078,808	684,364,105
Te ardhura nga Dividentet nga shoqeri me pjesemarrje	1,728,045,316	4,365,570
Total	3,241,124,124	688,729,675

19 SHITJET NETO

Ne kete shenim jane paraqitur te ardhurat nga aktiviteti i shoqerise qe eshte sherbimi i konsulences. Ky sherbim perfshin konsulence financiare, juridike, teknologjise se informacionit dhe menaxheriale. Te ardhura nga kontrata te tjera qeraje, shitje e AQT dhe te ardhura te tjera nga njohja e te ardhurave nga shit-blerje e kuotave, shoqerive etj.

Shitjet neto	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Sherbim Konsulence	155,096,183	104,342,411
Te ardhura te tjera sipas kontratave	103,467,231	70,070,000
Total	258,563,414	174,412,411
Të ardhura të tjera		
Te ardhura nga qerate	536,569	621,558
Te ardhura nga shitja e AQT	2,345,427	2,149,040
Total	2,881,996	2,770,598
Total	261,445,410	177,183,008

BALFIN SHPK*(Gjthe vlerat jane shprehur ne Lek)***20 SHPENZIME NGA VEPRIMTARITË E SHFRYTËZIMIT**

Shpenzimet jane njohur mbi bazen e te drejtave te konstatuara. Shpenzimet e tjera te veprimtarise, te klasifikuara sipas natyres, jane paraqitur ne vijim:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Zhvleresim i investimeve kapitale	378,944,016	-
Shpenzime te tjera per sherbime	28,405,714	14,338,471
Qera	20,505,641	19,301,492
Shpenzime te tjera	10,938,150	7,914,103
Shpenzime per trajnim personeli	10,354,440	-
Shpenzime noteriale ligjore	8,395,357	596,504
Transferime, udhetime dieta	5,293,110	13,531,527
Shpenzime postare dhe telekomunikacion	4,847,863	10,703,340
Shpenzime marketing	3,182,033	3,085,026
Te tjera per personelin	3,051,227	11,668,768
Per karburant	2,989,289	2,467,601
AQT te shitura	2,583,912	1,839,584
Ambjente te perbashketa	2,286,742	2,044,332
Blerje energji/ujje/avull	2,253,521	1,852,803
Shpenzime per pritje dhurata, sponsorizime	1,789,885	1,800,867
Shpenzime te tjera per zyre	1,647,013	2,055,172
Shpenzime per sherbime bankare	791,098	596,662
Blerje/Shpenzime te tjera per kancelari	579,765	1,111,243
Per sigurim dhe taksa	374,269	69,972
Taksa dhe tarifa vendore	128,416	37,120
Per riparim makinash	98,684	709,671
Total	489,440,145	95,724,260

21 SHPENZIME TE PERSONELIT

Shpenzimet per personelin perfaqesojne shpenzimet per paga shperblime dhe per shpenzimet shoqerore shendetesore te shoqerise.

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Shpenzime per Personelin		
Paga dhe shperblime	96,880,061	68,372,471
Shpenzime të sigurimeve shoqërore	9,455,621	7,242,701
Total	106,335,682	75,615,172

22 TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET FINANCIARE

Ne kete ze perfshihen te ardhura/shpenzime nga financimet e marra dhe te dhena, si dhe fitim/humbjet nga kembimet valutore.

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare		
Te ardhura nga interesat	10,642,442	4,912,298
Shpenzime per interesa	(13,346,437)	(5,498,284)
Fitimi nga kembimet valutore	15,079,586	1,757,922
Humbje nga kembimet dhe perkthimet	(73,687,471)	(10,206,327)
Total	(61,311,880)	(9,034,391)

BALFIN SHPK

(Gjithë vlerat janë shprehur në Lek)

23 SHPENZIMET E TATIM FITIMIT

Shpenzimi i tatim fitimit i llogaritur për vitin ushtrimor 2016 bazohet në detyrimin për tatim fitimin sipas Legjislacionin Fiskal në Shqipëri. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për vitin 2016 dhe 2015 është 15%. Për vitin ushtrimor shoqëria rezulton me një fitim para tatimit të realizuar në vlerën 2,838,295,099 Leke.

Më poshtë jepet detajimi i llogaritjes së tatim fitimit:

Rezultati tatimor	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Fitimi para tatimit	2,838,067,560	678,617,454
Te ardhura te perjashtuara (nga dividendet)	(3,241,124,124)	(688,729,675)
Te ardhura te pa tatueshme	(373,771)	-
Shpenzime te pazbritshme	399,321,740	19,788,474
Humbje e mbartur	-	(1,519,914)
Fitimi / humbje i tatueshem i ushtrimit	(4,108,595)	8,156,338
Tatim fitimi	-	1,223,451

24 ANGAZHIMET DHE DETYRIMET E KUSHTEZUARA

Me 31 Dhjetor 2016, Shoqëria ka angazhime me disa banka te nivelit te dyte ne Shqiperi duke qene se eshte bashke huammarrese ose garantore per disa prej kompanive te kontrolluara prej saj dhe kompanive te pa kontrolluara ne vlerat e meposhtme:

	31 dhjetor 2016
Angazhime per shoqerite e kontrolluara	2,820,461,433
Angazhime per shoqerite me pjesemarrje	59,117,729
Total	2,879,579,162

25 NGJARJE PAS DATES SE BILANCIT

Nuk ka asnjë ngjarje të mëposhtme pas datës së bilancit që kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.